



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Korrik 2021

Nr. 423

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit ndaj kandidatës për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Kërkues: Organizata “Qëndresa Qytetare”

Ndaj: Zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore, Kukës

Baza Ligjore: Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 17.03.2021, nëpërmjet emailit është raportuar një denoncim nga organizata “Qëndresa Qytetare”, me pretendimin se në ambientet e shkollës së mesme të bashkuar “Shemri” Kukës, është bërë prezantimi i kandidatës për deputete të Partisë Socialiste, zj. Gerta Duraku, në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.



Në cilësinë e provës “Qëndresa Qytetare” ka vendosur në dispozicion një link të rrjetit social “Facebook” në të cilin sipas saj, janë shpërndarë foto nga takimi, objekt i këtij denoncimi.

Linku: <https://www.facebook.com/1012875545404246/posts/5487957724562650/>

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, *“Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.”*

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Lidhur me këtë ankesë të Qëndresës Qytetare, e cila ka si objekt “Shkelje të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se ky ankim është objekt shqyrtimi nga ana e tij.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi “Qëndresa Qytetare”, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

Neni 3, pika 2 e vendimit 9/2020 përcakton subjektet të cilët gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi.



Duke qenë se denoncimi lidhet me kandidaten për deputete zj. Gerta Duraku, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, konstaton se kandidati për deputet nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi, për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit lidhur me shkeljen e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit rregullator në KQZ.

Referuar po kësaj dispozite, Komisioneri konstaton se Zyra Vendore Arsimore, Kukës, është subjekti i ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi.

II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3405 prot., datë 07.04.2021, i ka kërkuar Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti, të kandidates për deputete, zj. Gerta Duraku, në ambientet e administratës arsimore.

Me shkresën nr. 343/1 prot., datë 19.04.2021, administruar me tonën me nr. 3405/1 prot., datë 20.04.2021, Drejtori i zyrës Vendore Arsimore Kukës, zj. Dashurie Hasa, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës bën me dije prezantimi i kandidates është zhvilluar në ambientet e jashtme të shkollës së mesme, pas orës 16, sikurse dhe kandidatët e forcave të tjera politike.

Me shkresën nr. 4517, datë 5.5.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është adresuar sërish këtij institucioni, për t'i vënë në dispozicion fotot e e aktivitetit të zj. Duraku, paraqitur në cilësinë e provës nga denoncuesi Qendresa Qytetare dhe për t'i kërkuar risqarim nëse këto foto në çmimin e tyre, janë apo jo ambiente të shkollës së mesme të bashkuar "Shemri" Kukës.

Referuar nenit 7 të vendimit nr. 9 datë 09.04.2021 "Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre" të Komisionit Rregullator në KQZ, i cili parashikon se:

"Afati që ka KQZ-ja për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 ditë nga paraqitja e tij."



Edhe pse ka përfunduar afati 60 ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, pasi pritet edhe një përgjigje e Zyrës Vendore Arsimore Kukës, rëndësia e së cilës është thelbësore për shqyrtimin e çështjes.

Komisioneri shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 358, datë 17.05.2021 vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Qëndresës Qytetare, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj kandidatës për deputete zj. Gerta Duraku.

Me shkresën nr. 343/3 prot., datë 19.05.2021 protokolluar me tonën me nr. 4917/1 prot., datë 21.05.202, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, zj. Hasa ka kthyer përgjigje prezantimi i kandidatës është bërë në ambientin privat të z. Avdyl Brija dhe fotot e publikuara për këtë takim i përkasin këtij ambienti. Bashkëlidhur shkresës, zj. Hasa ka dërguar dhe konfirmimin e z. Brija gjithashtu dhe konfirmimin e administratorit të njësisë adminiztrative Malzi.

III. Analiza ligjore

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

Neni 91 pika 1 e Kodit Zgjedhor përcakton se “nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.”

Neni 3, pika 1.3, shkronja “c” e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikon se “veprimtari të ndaluara” janë edhe ato veprimtari që përfshijnë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të prashikuara në nenin 142 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësisive të vetqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron



kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrues të entit.”

Për sa më sipër, që të gjendemi në kushtet e ndalimit të parashikuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, pika 1.3, shkronja “c”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duhet që këto takime të zhvilluara me prezencën e kandidatës për deputete zj. Gerta Duraku, në ambientet e Shkollës së Mesme “Shemri ” Kukës, të jenë realizuar *në një aset të paluajtshëm, të parashikuar në nenin 142 të Kodit Civil.*

Nisur nga dy përgjigjet e Zyrës Vendore Arsimore, Kukës mbi këtë aktivitet si dhe duke marrë në analizë linkun e vënë në dispozicion nga denoncuesi “Qëndresa Qytetare” si elemente të vetme provuese të këtij denoncimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se e ka të pamundur të identifikojë nëse fotot e publikuara në rrjetin social Facebook, përbëjnë ose jo aktivitet të zhvilluar në ambientet e Shkollës së Mesme “Shemri ” Kukës.

Në çmim të fakteve dhe provave disponuar nga palët në këtë shqyrtim administrativ, nuk rezultoi e provuar se, ky aktivitet i zhvilluar me prezencën e zj. Gerta Duraku përbën *vënie në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia, ku me “burime” kuptohet aset i paluajtshëm, i parashikuar në nenin 142 të Kodit Civil, sipas përcaktimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.*

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga organizata “Qëndresa Qytetare” pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se aktiviteti i zhvilluar me prezencën e zj. Gerta Duraku, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n” dhe pika 2, 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr.



44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, vendimit nr. 9, datë 09.04.2021 të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidates për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të nenit 91 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Illirjan CELIBASHI

